



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo Unutrašnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs

Akademia e Kosovës për Siguri Publike/Kosovska Akademija za Javnu Bezbednost
Kosovo Academy for Public Safety

Më datë: 17.05.2016

Akademia e Kosovës për Siguri Publike

SHPALL KONKURS

Për zgjedhjen e personelit të **rregullt akademik** në Fakultetin e Sigurisë Publike, si në vijim:

- 1. Një mësimdhënës për lëndët:** Fillet e së drejtës, E drejtë administrative, E drejtë kushtetuese, Procedurë administrative;
- 2. Një mësimdhënës për lëndët:** Mbrojtja ndërkombëtare e të drejtave të njeriut; E drejta diplomatike dhe konsullore; Rreziqet dhe kërcënimet transnacionale;
- 3. Një mësimdhënës për lëndët:** Inteligjenca dhe hetimi, Siguria e informatës, Terrorizmi, Inteligjenca dhe analiza;
- 4. Një mësimdhënës për lëndët:** Gjuhë angleze I dhe II, Shkrim akademik I dhe II;

Personeli i rregullt akademik do të punojë me orar të plot (40 orë në javë), do të angazhohet për mësimdhënie akademike, kërkime shkencore - mësimore, mësimdhënie në trajnime si dhe në zhvillimin e kurikulave.

Zgjedhja e personelit të rregullt akademik do të bëhet në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr. 26/2013 për arsimin e lartë në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike.

Kandidatet që paraqiten në konkurs duhet të dorëzojnë:

- Kërkesën për aplikim;
- Një cv profesionale (modeli europass);
- Certifikatën e lindjes (jo me e vjetër së 6 muaj);

Adresa: Rr. Gjergj Kastrioti Skënderbeu - 42000 Vushtrri-Kosovë

Tel: 028 590 070, ext 210

Web: www.aksp-rks-gov.net

- Kopjen e diplomës, të studimeve themelore, master/magjistraturë dhe doktoratës (të noterizuara);
- Dëshmitë për publikimet shkencore e profesionale;
- Vendimin për nostrifikimin e diplomës (kandidatet që kanë mbaruar studimet jashtë vendit).
- Vendimin e zgjedhjes së fundit (kandidatet të cilët janë të punësuar në ndonjë institucion të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës);
- Si dhe informata tjera të cilat konsiderohen të rëndësishme për aplikantin.

Njohja e gjuhës angleze apo ndonjë gjuhë tjetër të huaj, është përparësi për konkuresit.

Të gjitha dokumentet duhet të dorëzohen në kopje fizike në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, në Vushtri, Ndërtesa e re administrative, Zyra e Personelit nr.01.

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).

Konkursi mbetet i hapur **15 ditë** kalendarike nga dita e shpalljes në gazetë, respektivisht deri me datën **31.05.2016**.

Aplikacionet e arritura pas afatit, si dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Akademia e Kosovës për Siguri Publike, ofron kushte të përshtatshme për kërkime dhe hulumtime shkencore me qëllim të arritjes së rezultateve konkurruese në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Andaj inkurajohen të aplikojnë kandidat me thirrje shkencore PhD, në fushat e kërkuar.

Konkursin mund ta gjeni të publikuar edhe në faqen e internetit në këtë adresë: <http://aksp.rks-gov.net/>.

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni Zyrën e Personelit, në numrin e tel: 028 590 070 Ext 210 ose 211, prej orës 08:00 - 1600.